



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA



www.komuna-kline.org

DREJTORIA E ARSIMIT

Nr. MA-25920 2026

Datë: 14.08 2026

Mbështetur në Ligjin për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës nr. 04/L-032, në Ligjin për Arsimin në Komunitet në Republikën e Kosovës nr. 03/L-068, në Ligjin për Arsimin dhe Aftësimin Profesional nr. 04/L-138, në UA nr. 22/2013 për numrin maksimal të nxënësve në klasë dhe raportin mësimdhënës-nxënës si dhe duke u mbështetur në kriteret për regjistrim që ka përcaktuar MASHTI, Drejtoria e Arsimit shpall:

K O N K U R S P L O T Ë S U E S

PËR REGJISTRIMIN E NXËNËSVE NË KLASËN E DHJETË (10) NË SHKOLLA TË MESME TË LARTA- NË GJIMNAZIN " LUIGJ GURAKUQI" DHE NË IAAP " FEHMI AGANI " NË KLINË PËR VITIN SHKOLLOR 2026/2027

Konkursi shpallet me këto kushte dhe kriteret:

1. Kushtet e përgjithshme për regjistrimin e nxënësve të rregullt

Për regjistrimin e nxënësve në klasën e 10-të të gjimnazeve dhe të shkollave profesionale, sipas konkursit plotësues, për vitin shkollor 2026/2027 mund të konkurrojnë kandidatët, të cilët e kanë mbaruar arsimin e obligueshëm dhe nuk janë më të vjetër se 17 vjeç.

Nxënësit, të cilët e kanë mbaruar klasën e 9-të jashtë Kosovës, obligohen ta bëjnë nostrifikimin e dëftesave në MASHTI dhe pastaj të konkurrojnë për regjistrim.

2. Dokumentet e nevojshme për konkurrim

Nxënësit për të konkurruar për regjistrim në klasën e 10-të në gjimnaze dhe shkolla profesionale, duhet të paraqesin këto dokumente:

Fletëparaqitjen (e cila merret në shkollën në të cilën konkurron)

Dëftesën origjinale për kryerjen e shkollës së mesme të ulët (6-9) dhe

Certifikatën e lindjes.

Gjimnazi "Luigj Gurakuqi"-Klinë

Nr.	Drejtimi	Profili arsimor	Nr. i paraleleve	Nr. i nx. në par.	Gjithsej nxënës
1	Gjimnaz	shkenca natyrore	2	30	60
2	Gjimnaz	shoqëroro-gjuhësor	3	32	96
Gjithsej			5	Nx. në par.30-32	Gjithsej nxënës 156

IAAP "Fehmi Agani", Klinë

Komuna	Shkolla	Drejtimi	Profili	Nr.i paral.	Nr.i nxën.
Klinë	"Fehmi Agani"	Makineri, prodhim dhe ndertimtari	Operator i pordhimit	1	16
			Trafik rrugor	1	14
			Metaltpunues	1	18
			Instalues elektrik	1	6
			Gjeologji	1	17
			Miniera	1	17
			Instalues i ngrohjes, klimatizimit dhe ujesjellesit	1	13
		Agrokulturë, pylltari, peshkatari dhe veterinari	Mbrojtja e bimëve	1	18
			Teknologji ushqimore	1	12
			Gjithsej: Klinë	9	131

SHKOLLAT MJEKËSORE

Kline	Fehmi Agani	Shëndeti dhe mirëqenia	Bashkëpunor profesional i infermierisë	1	27
			Gjithsej: Kline	1	27

3. Afati i paraqitjes së dokumenteve dhe shpallja e rezultateve

Paraqitja e dokumenteve për gjimnaze dhe shkolla profesionale sipas konkursit plotësues për vitin shkollor 2026/2027, bëhet më datën **17, 18 e 19 gusht 2026** në lokalet e shkollës amë ku nxënësi dëshiron të regjistrohet duke filluar nga ora **8.00-16.00**.

Rezultatet për pranimin e nxënësve shpallen në shkollat përkatëse më datën **20.8.2026**.

Nxënësi i pakënaqur me rezultatin e publikuar ka të drejtë ankese brenda dy (2) ditësh pune nga koha e shpalljeve të rezultateve. Ankesat parashtrohen në drejtorinë e shkollës. Ankesat në shkallën e dytë bëhen në Drejtorinë Komunale të Arsimit brenda dy (2) ditësh pune pas pranimit të përgjigjes nga shkolla.

A. Kriteret për regjistrim

Nxënësi për regjistrim në klasën e 10-të duhet t'i plotësojë këto kritere:

- | | |
|---|---------------|
| 1. Suksesi nga shkollimi i obliguar | (40%) 40 pikë |
| 2. Suksesi nga lëndët prioritare nga shkollimi i obliguar | (20%) 20 pikë |
| 3. Numri i pikëve nga testi | (40%) 40 pikë |

Nxënësi maksimalisht mund t'i fitojë (100%) 100 pikë.

Kriteri i lëndëve prioritare nga suksesi për gjimnaze dhe shkolla të mjekësisë është që mesatarja e këtyre lëndëve të jetë minimum 4.00 (së pari llogaritet mesatarja e lëndëve veç e veç për klasat 6-9, pastaj mesatarja e mesatareve të atyre lëndëve).

Kriteri i lëndëve prioritare nga testi për gjimnaze dhe shkolla të mesme të mjekësisë është minimumi 40% i pikëve nga ato lëndë.

- Nxënësi nga suksesi i përgjithshëm nga shkollimi i obligueshëm (klasa 6,7, 8, 9) mund t'i fitojë maksimalisht 40 pikë.

Formula për llogaritjen e pikëve të suksesit është:

Suksesi (klasa 6 + klasa 7 + klasa 8 + klasa 9) x 2 = 40 pikë max.

Nxënësi nga suksesi i përgjithshëm i lëndëve prioritare maksimalisht mund t'i fitojë 20 pikë:

mesatarja e lëndës (I) + mesatarja e lëndës (II) + mesatarja e lëndës (III) + mesatarja e lëndës (IV) = 20 pikë max.

- Lëndët me prioritet në sukses sipas drejtimeve të gjimnazeve:
 - a. Gjimnazi i shkencave natyrore: Fizikë, Kimi, Biologji, Matematikë
 - b. Gjimnazi i shkencave shoqërore dhe gjuhësore: Gjuhë amtare, Gjuhë angleze, Histori, Gjeografi
- Lëndët me prioritet në sukses sipas profileve në IAAP:
 - a. Shëndetësi, Bujqësi, Teknologji Ushqimore dhe Veterinari:

Biologji, Kimi, Fizikë, Gjuhë shqipe dhe letërsi.

- b. Makineri, Elektroteknikë, TIK, Tekstil, Gjeodezi, Ndërtimtari, Xehetari, Gjeologji, Grafikë, Komunikacion, Kimi-Teknologji, PTT, :

Matematikë, TIK, Fizikë, Gjuhë shqipe dhe letërsi.

- c. Ekonomi, administratë:

Matematikë, Gjuhë shqipe dhe letërsi, Gjuhë angleze, Gjeografi

- d. Juridik dhe administratë:

Edukatë qytetare, Histori, Gjuhë shqipe dhe letërsi, Gjeografi

- e. Tregti, hotelieri dhe turizëm:

Gjuhë shqipe dhe letërsi, Histori, Edukatë qytetare,, Gjeografi

4. Kriteri i suksesit të notave në lëndët prioritare sipas drejtimeve përkatëse:

- **Gjimnazi i shkencave natyrore-** Mesatarja e lëndëve: fizikë, kimi, biologji dhe matematikë duhet të jetë së paku 4 (katër) si dhe 40% të pikëve nga lëndët prioritare në test (10 pikë nga lëndët: fizikë, kimi dhe biologji).

$$\frac{\text{Mes (kimi)} + \text{mes (biologji)} + \text{mes (fizikë)} + \text{mes (matematikë)}}{4} \geq 4$$

- **Gjimnazi i shkencave shoqërore dhe gjuhësore-** Mesatarja e lëndëve: gjuhë shqipe, gjuhë angleze, histori, gjeografi së paku duhet të jetë 4 (katër) si dhe 40% të pikëve nga lëndët prioritare në test (20 pikë nga lëndët gjuhë shqipe, gjuhë angleze, histori, gjeografi)

$$\frac{\text{Mes (gjuhë shqipe)} + \text{mes (gjuhë angleze)} + \text{mes (histori)} + \text{mes (gjeografi)}}{4} \geq 4$$

- **Shkollat e shëndetësisë-** Mesatarja e lëndëve: kimi, biologji, fizikë dhe gjuhë amtare së paku duhet të jetë 4 (katër) si dhe 40% të pikëve nga lëndët prioritare në test (10 pikë nga lëndët fizikë, kimi dhe biologji):

$$\frac{\text{mes (kimi)} + \text{mes (biologji)} + \text{mes (fizikë)} + \text{mes (gjuhë shqipe)}}{4} \geq 4$$

B. Përmbajtja e testit- numri i kërkesave (pyetjeve) sipas lëndëve

I. Gjuhë

- | | | |
|------------------|---------|--------------------|
| 1. Gjuhë shqipe | 20 pikë | |
| 2. Gjuhë angleze | 5 pikë | (gjithsej 25 pikë) |

II. Shkencat shoqërore

- | | | |
|--------------|---------|--------------------|
| 1. Gjeografi | 12 pikë | |
| 2. Histori | 13 pikë | (gjithsej 25 pikë) |

III. Matematikë

- | | | |
|----------------|---------|--------------------|
| 1. Matematikë | 20 pikë | |
| 2. Informatikë | 5 pikë | (gjithsej 25 pikë) |

IV. Shkencat natyrore

- | | | |
|-------------|--------|--------------------|
| 1. Fizikë | 8 pikë | |
| 2. Kimi | 8 pikë | |
| 3. Biologji | 9 pikë | (gjithsej 25 pikë) |

5. Renditja e lëndëve me prioritet në test sipas drejtimeve të gjimnazeve:

1. Gjimnazi shkencat e natyrës:

- | | |
|---------------------------------------|----------------------------|
| 1. Shkencat e natyrës: 25 | $25 \times 0.8 = 20$ pikë |
| 2. Matematikë dhe Informatikë: 25 | $25 \times 0.4 = 10$ pikë |
| 3. Gjuhë amtare dhe gjuhë angleze: 25 | $25 \times 0.3 = 7.5$ pikë |
| 4. Shkencat shoqërore: | $25 \times 0.1 = 2.5$ pikë |
| | (gjithsej 40 pikë) |

2. Gjimnazi shoqëror dhe gjuhësor:

- | | |
|--------------------------------------|----------------------------|
| 1. Shkenca shoqërore 25 | $25 \times 0.6 = 15$ pikë |
| 2. Gjuhë amtare dhe gjuhë angleze 25 | $25 \times 0.6 = 15$ pikë |
| 3. Matematikë dhe Informatikë 25 | $25 \times 0.3 = 7.5$ pikë |
| 4. Shkenca natyrore 25 | $25 \times 0.1 = 2.5$ pikë |
| | (gjithsej 40 pikë) |

6 Renditja e lëndëve me përparësi sipas profileve në IAAP

I. Shëndetësi, Bujqësi dhe Veterinari

- | | |
|--------------------------------------|----------------------------|
| 1. Shkencat natyrore 25 | $25 \times 0.8 = 20$ pikë |
| 2. Gjuhë amtare dhe gjuhë angleze 25 | $25 \times 0.4 = 10$ pikë |
| 3. Matematikë dhe Informatikë 25 | $25 \times 0.3 = 7.5$ pikë |
| 4. Shkencat shoqërore 25 | $25 \times 0.1 = 2.5$ pikë |
| | (gjithsej 40 pikë) |

II. Makineri, Elektroteknikë, Gjeodezi, Ndërtimtari, Xehetari, Gjeologji, Grafikë dhe Komunikacion, Kimi – Teknologji

1. Matematikë dhe Informatikë 25
2. Gjuhë amtare dhe gjuhë angleze 25
3. Shkenca natyrore 25
4. Shkenca shoqërore 25

$25 \times 0.8 = 20$ pikë
 $25 \times 0.4 = 10$ pikë
 $25 \times 0.3 = 7.5$ pikë
 $25 \times 0.1 = 2.5$ pikë
 (gjithsej 40 pikë)

III Ekonomi

1. Matematikë dhe Informatikë 25
2. Gjuhë amtare dhe gjuhë angleze 25
3. Shkenca shoqërore 25
4. Shkenca natyrore 25

$25 \times 0.8 = 20$ pikë
 $25 \times 0.4 = 10$ pikë
 $25 \times 0.3 = 7.5$ pikë
 $25 \times 0.1 = 2.5$ pikë
 (gjithsej 40 pikë)

IV. Juridik

1. Shkencat shoqërore 25
2. Gjuhë amtare dhe gjuhë angleze 25
3. Matematikë dhe Informatikë 25
4. Shkenca natyrore 25

$25 \times 0.8 = 20$ pikë
 $25 \times 0.4 = 10$ pikë
 $25 \times 0.3 = 7.5$ pikë
 $50 \times 0.1 = 2.5$ pikë
 (gjithsej 40 pikë)

V. Tregti, Hotelieri dhe Turizëm

1. Gjuhë amtare dhe gjuhë angleze 25
2. Shkenca shoqërore 25
3. Matematikë dhe Informatikë 25
4. Shkenca natyrore 25

$25 \times 0.8 = 20$ pikë
 $25 \times 0.4 = 10$ pikë
 $25 \times 0.3 = 7.5$ pikë
 $25 \times 0.1 = 2.5$ pikë
 (gjithsej 40 pikë)

DREJTORI I DKA-së
 Dr.sc.Qemajl Sejdiu

